



THIRRJE PUBLIKE

PËR MBËSHTETJEN E KONSUMATORËVE FAMILJARË NË INVESTIMIN NË SISTEME TË ENERJISË SË RIPËRTËRITSHME- Sistemi fotovoltaik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike për vetë-konsum

Që nga viti 2021, kriza energjetike nëpër të cilën po kalon Evropa ka përkeqësuar situatën me furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës. Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të prodhimit vendor të energjisë elektrike, varësia nga importi dhe çmimet jostabile të energjisë elektrike në tregun ndërkombëtar kanë krijuar pasiguri në furnizimin me energji elektrike. Një situatë e tillë vlerësohet që pengon edhe zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës, duke shkaktuar rrjedhimisht kosto të larta për ekonomitë familjare si dhe për bizneset.

Sipas statistikave, konsumatori më i madh i energjisë elektrike në Republikën e Kosovës është sektori rezidencial, i cili kontribuon rreth (40%) në konsumin final të saj. Ulja e konsumit përmes rritjes së Efiçencës së Energjisë (EE) ndikon në reduktimin e kërkesës për energji elektrike duke ndihmuar familjet për të reduktuar faturat e energjisë e elektrike, por edhe përmirësuar sigurinë e furnizimit.

Qeveria e Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh këtë situatë të paqëndrueshme të furnizimit me energji, ka ndërmarr masa konkrete në adresimin e saj. Në linjë sipas Vendimit¹ Nr. 29/112, datë 13.12.2022, i plotësuar me Vendimin¹ Nr.03/128, datë 16.02.2023, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar Planin e Veprimit për Zbutjen e Ndikimit të Menjëhershëm Socio-Ekonomik të Krizës Energjetike në shumë prej shtatëdhjetë e pesë (75) milionë euro, si parakusht për përfitimin e mjeteve financiare nga Bashkimi Evropian (BE) për Programin Vjetor IPA 2023.

Ky Plan parasheh zbatimin e masave me efekte të menjëhershme dhe afatshkurtra për periudhën e dimrit, përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë financiare për familjet në nevojë dhe në disavantazh social, nxitjen e kursimit të energjisë elektrike nga konsumatorët familjarë, mbështetjen e familjeve përmes rritjes së Efiçencës së Energjisë (EE) në njësitë e banimit dhe të ndërtesave si dhe investimeve në pajisje efiçente për ngrohje, pajisjeve elektro-shtëpiake efiçente dhe sisteme të energjisë së ripërtëritshme për konsumatorët familjarë.

Bazuar në Masën katër (4) të Planit të Veprimit për Zbutjen e Ndikimit të Menjëhershëm Socio-Ekonomik të Krizës Energjetike, Ministria e Ekonomisë (ME), shpall Thirrje Publike për mbështetjen e konsumatorëve familjarë, në veçanti konsumatorët në nevojë në investimin në sisteme të energjisë së ripërtëritshme - Sistemi fotovoltaik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike.

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30>



1 SISTEMI QË DO TË SUBVENCIONOHET PËR KONSUMATORËT FAMILJARË

Instalimi i sistemit fotovoltaik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike për vetë-konsum.

Subvencionohet vetëm një (1) sistem fotovoltaik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike për vetë-konsum për një (1) shtëpi dhe sistemi duhet të blihet i ri.

Vërejtje: Nëse keni qenë përfitues të subvencionit për masën “Instalimi i sistemit diellor për ngrohjen e ujit sanitar” të thirrjes publike Nr.02/2023, më datë 18.08.2023, ju nuk keni të drejtë të aplikoni për masën “Instalimi i sistemit fotovoltaik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike për vetë-konsum”.



2 KRITERET TEKNIKE DHE TË PËRGJITHSHME

Në tabelën më poshtë mund të gjeni kriteret për aplikim, kriteret teknike, vlerën e subvencionit dhe sqarimet shtesë për secilën prej pajisjeve që do të subvencionohen.

Tabela 1.0

SISTEMI	KRITERET PËR APLIKIM	KRITERET TEKNIKE TË PAJISJES	VLERA E SUBVENCIONIMIT	SQARIME SHITESË
Instalimi i sistemit fotovoltaik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike për vetë-konsum	<p>Kriteret për aplikim për fazën I:</p> <p>a. Shtëpia juaj duhet të jetë në grupin tarifor 4/01 ose 4/02 (amvisëri);</p> <p>b. Shtëpia juaj duhet të jetë e termoizoluar²</p> <p>c. Shtëpia duhet të jetë e banuar dhe konsumi mujor i energjisë elektrike nuk është më i vogël se 250 kWh/muaj në të paktën dhjetë (10) muaj brenda dymbëdhjetë (12) muajve të vitit 2023.</p>	<p>Modulet fotovoltaike (FV)</p> <p>a. Modulet fotovoltaike (FV) duhet të jenë të kualifikuara konform IEC (International Electrotechnical Commission) aktuale apo çertifikime tjera ndërkombëtare valide për tregun e Bashkimit Evropian siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ISO – International Standardization Organization • EN - European Standards 	Subvencionohet 250 €/kWp dhe deri në 1750.00 € .	<p>Për arsye teknike, ky sistem fotovoltaik është i aplikueshëm vetëm për shtëpi.</p> <p>Për konsumatorët familjar të energjisë elektrike të kyçur në tensionin e ulët të rrjetit të shpërndarjes (0.4kV), kapaciteti maksimal i instaluar është 7 kWp sipas Rregullës së ZRRE për vetë-konsumatorët me</p>

²Mbështjellësi i jashtëm i shtëpisë: Muret e jashtme të shtëpisë duhet të jenë të izoluara termikisht (p.sh stitopor,lesh guri) dhe dritaret/dyert e jashtme të jenë në gjendje të mirë teknike dhe fizike dhe së paku të jenë me dy shtresa xhami.



	<p>d. Të ketë konsumin minimal vjetor në vitin e fundit³, 4,000⁴ kWh/vit</p> <p>e. Kapaciteti i propozuar për investim në momentin e aplikimit të jetë në përputhje me Rregulloren në fuqi të ZRRE për Vetë – Konsumatorët me Burime të Ripërtëritshme.</p> <p>f. Projekti duhet të jetë i përgatitur nga njëra prej kompanive instaluese të regjistruara në Kosovë.</p> <p>g. Të ketë Pëlqim për Kycje në rrjet nga KEDS (nga data e hyrjes në fuqi të rregullës për vetë-konsumatorët nga ZRRE).</p> <p>Kriteret për aplikim për fazën II:</p>	<p>IEEE Institute of Electrical and Electronics Engineers</p> <p>b. Fuqia nominale e moduleve fotovoltaike është > 250 Wp</p> <p>c. Efiçienca e moduleve fotovoltaike në kushtet standarde të testimit (STC) të mos jetë më e vogël se 20 %.</p> <p>d. Modulet fotovoltaike duhet të jenë të garantuara për së paku dhjetë (10) vite ndaj dështimeve për shkak të defekteve dhe cilësisë së materialeve.</p> <p>e. Modulet fotovoltaike (FV) duhet të kenë degradim linear të fuqisë jo më shumë se 0.8 % për vit deri në vitin e njëzet e pestë (25) të operimit</p>		<p>Burime të Ripërtëritshme.</p>
--	---	--	--	----------------------------------

³ Periudhën kohore janar – dhjetor 2023

⁴ Sqarim: Kërkesa e konsumit vjetor të energjisë elektrike prej 4000 kWh/vit buron prej faktit se projektet me fuqi të instaluar nën 3 kWp kanë kosto më të lartë për njësi, dhe efekti në kursim është shumë i ulët.



	<p>a. Të ketë autorizimin nga ZRRE (nga data e hyrjes në fuqi të rregullës për vetë-konsumatorët nga ZRRE).</p> <p>b. Të ketë raportin e pranimit teknik të kapacitetit të instaluar nga KEDS për energjizim.</p>	<p>(përfshijmë vitin të parë të operimit).</p> <p>f. Gama e temperaturës të mos jetë më e ulët se $-30\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri $+50\text{ }^{\circ}\text{C}$</p> <p>g. Korniza e moduleve fotovoltaike (FV) duhet të jetë e përbërë nga materiale rezistente ndaj korrozionit</p> <p>h. Ngarkesa e lejuar e borës/erës: jo më pak se 5300 Pa / 2300 Pa</p> <p>i. Të pajisur me markën e konformitetit CE</p> <p>Dizajnimi i strukturës për montimin e moduleve fotovoltaike (FV)</p> <p>a. Struktura montuese duhet të projektohet në atë mënyrë që të përballojë shpejtësinë e erës në zonat ku propozohet të instalohen sistemet fotovoltaike (FV). Dizajni i</p>		
--	---	--	--	--



		<p>strukturës për montimin e moduleve fotovoltaike në çati duhet të jetë i përshtatshëm me faktor të sigurisë jo më të vogël se 1.5.</p> <p style="text-align: center;">Invertori</p> <ul style="list-style-type: none">a. Të pajisur me markën e konformitetit CEb. Invertori/ët duhet të jetë i/të kualifikuar(a) konform (International Electrical Code -IEC) aktuale apo çertifikime tjera ndërkombëtare valide per tregun e Bashkimit Evropianc. Invertori duhet të ketë të garanci ≥ 5 vite.d. Efiçienca maksimale e invertorit të mos jetë më e vogël se 97%e. Gama e temperaturës të mos jetë më e ulët se $-20\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri + $50\text{ }^{\circ}\text{C}$		
--	--	---	--	--



		<p>f. Gama e ndryshimit të frekuencës brenda: 45-55 Hz</p> <p>g. Faktori i fuqisë në fuqinë nominale duhet të jetë më i madh ose i barabartë me 0.99</p> <p>h. Shkalla e mbrojtjes (sipas IEC 60529): IP 65</p> <p>i. Invertori duhet të ketë sistem mbrojtjeje të brendshme (të integruar): (i) Mbrojtje nga mbirryma në anën AC dhe DC (ii) Mbrojtje nga mbitensioni/nëntensioni AC (iii) Mbrojtje nga mbifrekuenca/nënfrekuenca AC (iv) Mbrojtje kundër polaritetit të kundërt të lidhjes në anën DC (v) Mbrojtje ndaj ishullit (anti-islanding)</p> <p>j. Invertori duhet të jetë i pajisur me ekran për të monitoruar të</p>		
--	--	---	--	--



		<p>dhënat e paraqitura si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none">(i) Fuqia DC në hyrje(ii) Tensioni DC në hyrje(iii) Rryma DC(iv) Fuqia AC në dalje(v) Tensioni AC në dalje(vi) Rryma AC në dalje <p style="text-align: center;">Kabllo</p> <ul style="list-style-type: none">a. Kabllot duhet të jenë të kualifikuara konform IEC aktuale apo çertifikime tjera ndërkombëtare valide per tregun e Bashkimit Evropianb. Kabllot duhet të jenë kompatible për sistemet fotovoltaike (FV) që mund t'i rezistojnë kushteve të vështira mjedisore, duke përfshirë temperaturat e larta, rrezatimin UV, shiun, lagështinë, papastërtitë, ekspozimin ndaj mikrobeve dhe tensionet sipas standardeve më të fundit të IEC		
--	--	--	--	--



		<p>c. Të pajisur me markën e konformitetit CE</p> <p style="text-align: center;">Kutitë Shpërndarëse</p> <p>a. Të gjitha kutitë duhet të jenë të pajisura me elementet adekuate mbrojtëse, funksionalitetin e duhur dhe sigurinë (përfshirë siguresat, tokëzimin, etj).</p> <p>b. Kutitë duhet të jenë të papërshkrueshme nga uji, parazitët, pluhuri, dhe duhet të jenë të prodhuar nga materiale termoplastike / metalike në përputhje me IEC 62208, rezistent ndaj rrezeve UV (ultraviolete) dhe ndaj zjarrit, si dhe të ketë mbrojtje minimale me IP 65 (ambient të jashtëm) dhe IP 20 (ambient të brendshëm).</p> <p>c. Të pajisur me markën e konformitetit CE</p>	
--	--	---	--



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy



Funded by
the European Union

3 MËNYRA E APLIKIMIT PËR SUBVENCION

Aplikimi për subvencionim është e ndarë në dy (2) faza dhe në të dy (2) fazat aplikimi bëhet online përmes platformës e-Kosova.

Hapat për aplikim

Faza I

1. Sigurohuni që plotësoni kriterin për aplikim në lidhje me konsumin e energjisë elektrike këtu: <https://ekosova.rks-gov.net/485>
2. Shkarkoni formularin “Shtojca 1” nga platforma e-Kosova në linkun më lart dhe me ndihmën e kompanisë instaluese plotësoni dhe ngarkoni formularin;
3. Ngarkoni dëshminë e marrjes së pëlqimit për kyçje në rrjet nga KEDS (nga data e hyrjes në fuqi të rregullës për vetë-konsumatorët nga ZRRE);
4. Ngarkoni fotografi të sipërfaqes ku do të instalohen panelet solare fotovoltaike;

Pas verifikimit nga komisioni se dokumentacionet e kërkuara janë konform kriterëve, ju do të njoftoheni se jeni kualifikuar për këtë fazë dhe mund të vazhdoni me instalimin e sistemit fotovoltaik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike sipas kriterëve teknike të specifikuara në thirrje. Për rezultatet e aplikimit në fazën I do të njoftoheni sipas afateve zyrtare, brenda dhjetë (10) ditë pune.

Vegëzën (linkun) për aplikim në fazën e dytë do ta pranoni në email adresën me të cilën e keni hapur llogarinë e juaj në e-Kosova.



Faza II

Pas instalimit të sistemit fotovoltaiik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike për vetë-konsum, sipas kriterëve të specifikuara në thirrje, ju duhet të aplikoni për fazën II përmes platformës e-Kosova që të ju mundësohet përfitimi nga ky subvencion, duke ngarkuar dokumentet në vijim:

1. Kuponin fiskal apo faturën e rregullt me dëshmi të pagesës përmes transferit bankar të blerjes së sistemit (*data e blerjes duhet të jetë nga data e shpalljes së thirrjes më 06.02.2024*);
2. Fotografi të sistemit fotovoltaiik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike për vetë-konsum të instaluar sipas kriterëve të specifikuara në thirrje;
3. Broshura e prodhuesit (data sheet) me specifikacionet teknike të moduleve fotovoltaiike që dëshmon përmbushjen e kriterëve për verifikim preliminar (Pika V e Shtojcës 1);
4. Broshura e prodhuesit (data sheet) me specifikacionet teknike të invertorit që dëshmon përmbushjen e kriterëve për verifikim preliminar (Pika V e Shtojcës 1);
5. Dëshminë e autorizimit nga ZRRE (nga data e hyrjes në fuqi të rregullës për vetë-konsumatorët nga ZRRE);
6. Raportin e pranimit teknik të kapacitetit të instaluar nga KEDS për energjizim, sipas legjislacionit në fuqi;
7. Marrëveshja juaj e subvencionimit do të gjenerohet automatikisht në platformën e-Kosova. Kjo marrëveshje duhet patjetër të shkarkohet, të nënshkruhet, dhe të ngarkohet së bashku me dokumentet e sipërpërmendura.

Në këtë fazë ju kërkohet të vendosni numrin e xhirollogarisë tuaj bankare e cila duhet të jetë në emër të aplikuesit dhe nga ndonjëra prej bankave të licencuara brenda Republikës së Kosovës.

Pas ngarkimit të dokumenteve të listuara më lartë në platformën online e-Kosova, ju do të pranoni një (1) njoftim automatik me përmbajtjen: *“Aplikimi juaj është realizuar me sukses. Aplikacioni juaj do të vlerësohet nga Komisioni përkatës i Ministrisë së Ekonomisë (ME), i cili do të shqyrtojë nëse dëshmitë e ngarkuara në platformën e-Kosova janë konform kriterëve të kësaj thirrjeje. Për rezultatet e aplikimit do të njoftoheni sipas afateve zyrtare”*.

Nëse aplikacioni juaj vlerësohet pozitivisht nga Komisioni përkatës i Ministrisë së Ekonomisë (ME), ju do të njoftoheni përmes platformës e-Kosova dhe do të pranoni mjetet nga subvencionin në xhirollogarinë tuaj.

Sistemi fotovoltaiik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike, duhet të jetë i instaluar dhe i gatshëm për inspektim nga momenti që aplikoni për fazën e dytë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy



Funded by
the European Union

Afati për aplikim

Afati i fundit për aplikim për fazën e parë është deri me datën **31 maj të vitit 2024**, ose deri në shpenzimin e buxhetit të alokuar për këtë thirrje. Aplikimet e pranuar në fazën e parë do të shqyrtohen bazuar në parimin "**KUSH APLIKON I PARI, SHËRBEHET I PARI**", andaj inkurajoheni të aplikoni sa më herët.

Ndërsa, afati i fundit për fazën e dytë është deri me datën **30 shtator të vitit 2024**.

E drejta për ankesë

Aplikantët të cilët vlerësojnë se aplikimi i tyre nuk është vlerësuar drejtë nga Komisioni përkatës i Ministrisë së Ekonomisë (ME), mund të ushtrojnë të drejtën e ankesës në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të njoftimit, konform Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA). Ankesa i drejtohet Ministrisë së Ekonomisë (ME) si autoritet që ka publikuar thirrjen në email adresën: ✉ komisioni.ankesa@rks-gov.net

Sqarime shtesë

Për më shumë informacione dhe sqarime shtesë rreth fazave të aplikimit mund të drejtoheni me shkrim në email adresën: ✉ info.subvencionet@rks-gov.net apo të kontaktoni në numrat e telefonit si më poshtë:

☎ 038 200 215 89

☎ 038 200 215 55

Nga e hëna deri të premten, duke filluar nga ora: 08:30-12:00 dhe nga ora 13:00-16:00.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Ekonomisë
 Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy



Funded by
 the European Union

Shtojca 1: Formulari i aplikimit (plotësohet me ndihmën e kompanisë instaluese)

I. Të dhënat e aplikuesit	
Emri	
Mbiemri	
Nr. Personal	
Adresa e shtëpisë	
Telefoni	
E-mail	
Të dhënat e mëposhtme të plotësohen nga kompania instaluese	
II. Të dhënat elektro-energjetike	
Shifra e konsumatorit (KESCO ID):	_____ <input type="checkbox"/> Projekti i propozuar FV ka pëlqim nga KEDS
Niveli i tensionit të kyçjes:	<input type="checkbox"/> 0.4 kV
Grupi tarifor:	<input type="checkbox"/> 4/01 Amvisëri <input type="checkbox"/> 4/02 Amvisëri
Konsumi minimal vjetor në vitin e fundit:	<input type="checkbox"/> > 4,000 kWh
III. Të dhënat e sistemit fotovoltaik (FV)	
Kapaciteti i sistemit FV:	_____ kWp
Prodhimi vjetor i sistemit FV:	_____ kWh
Konsumi vjetor i objektit:	_____ kWh
Kosto totale e sistemit FV:	_____ Euro
Kosto specifike e sistemit FV:	_____ Euro/kWp
Hapësira e mbuluar me module fotovoltaike:	_____ m ²
<input type="checkbox"/> Objekti ka hapësirë të mjaftueshme në kulm për sistemin FV	



IV. Implementuesi dhe deklarata mbi standardet teknike	
Emri i biznesit instalues	
Numri i biznesit instalues (NUI)	
E-mail adresa	
Numri i telefonit	
V. Kriteret teknike të përzgjedhura për verifikim:	
Të dhënat për pajisjet:	Kriteri i kërkuar për verifikim (<i>shëno me X nëse përmbushet kriteri</i>)
<u>Modulet fotovoltaike (FV)</u>	<input type="checkbox"/> Efiçienca e moduleve fotovoltaike në kushtet standarde të testimit (STC) të mos jetë më e vogël se 20 % <input type="checkbox"/> Të pajisur me markën e konformitetit CE
<u>Invertori</u>	<input type="checkbox"/> Efiçienca maksimale e invertorit të mos jetë më e vogël se 97% <input type="checkbox"/> Të pajisur me markën e konformitetit CE
VI. Kriteret minimale teknike të kërkuara: (<i>shëno me X nëse përmbushet kriteri</i>)	
<p>Modulet fotovoltaike (FV)</p> <p><input type="checkbox"/> Modulet fotovoltaike (FV) duhet të jenë të kualifikuara konform IEC (International Electrotechnical Commission) aktuale apo çertifikime tjera ndërkombëtare valide për tregun e Bashkimit Evropian siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> •ISO – International Standardization Organization •EN - European Standards •IEEE Institute of Electrical and Electronics Engineers <p><input type="checkbox"/> Fuqia nominale e moduleve fotovoltaike është > 250 Wp</p> <p><input type="checkbox"/> Modulet fotovoltaike duhet të jenë të garantuara për së paku dhjetë (10) vite ndaj dështimeve për shkak të defekteve dhe cilësisë së materialeve.</p> <p><input type="checkbox"/> Modulet fotovoltaike (FV) duhet të kenë degradim linear të fuqisë jo më shumë se 0.8 % për vit deri në vitin e njëzet e pestë (25) të</p>	<p>Invertori</p> <p><input type="checkbox"/> Invertori/ët duhet të jetë i/të kualifikuar(a) konform (International Electrical Code -IEC) aktuale apo çertifikime tjera ndërkombëtare valide për tregun e Bashkimit Evropian</p> <p><input type="checkbox"/> Invertori duhet të ketë të garanci ≥ 5 vite.</p> <p><input type="checkbox"/> Gama e temperaturës të mos jetë më e ulët se -20 °C deri + 50 °C</p> <p><input type="checkbox"/> Gama e ndryshimit të frekuencës brenda: 45-55 Hz</p> <p><input type="checkbox"/> Faktori i fuqisë në fuqinë nominale duhet të jetë më i madh ose i barabartë me 0.99</p> <p><input type="checkbox"/> Shkalla e mbrojtjes (sipas IEC 60529): IP 65</p> <p><input type="checkbox"/> Invertori duhet të ketë sistem mbrojtjeje të brendshme (të integruar):</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) Mbrojtje nga mbirryma në anën AC dhe DC (ii) Mbrojtje nga mbitensioni/nëntensioni AC (iii) Mbrojtje nga mbifrekuenca/nënfrekuenca AC (iv) Mbrojtje kundër polaritetit të kundërt të lidhjes në anën DC



operimit (përfshirë vitin e parë të operimit).

Gama e temperaturës të mos jetë më e ulët se $-30\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri $+50\text{ }^{\circ}\text{C}$

Korniza e moduleve fotovoltaike (FV) duhet të jetë e përbërë nga materiale rezistente ndaj korrozionit

Ngarkesa e lejuar e borës/erës: jo më pak se $5300\text{ Pa} / 2300\text{ Pa}$

Dizajni i strukturës për montimin e moduleve fotovoltaike (FV)

Struktura montuese duhet të projektohet në atë mënyrë që të përballojë shpejtësinë e erës në zonat ku propozohet të instalohen sistemet fotovoltaike (FV). Dizajni i strukturës për montimin e moduleve fotovoltaike në çati duhet të jetë i përshtatshëm me faktor të sigurisë jo më të vogël se 1.5.

Kabllo

Kabllot duhet të jenë të kualifikuara konform IEC aktuale apo certifikime tjera ndërkombëtare valide për tregun e Bashkimit Evropian

Kabllot duhet të jenë kompatible për sistemet fotovoltaike (FV) që mund t'i rezistojnë kushteve të vështira mjedisore, duke përfshirë temperaturat e larta, rrezatimin UV, shiun, lagështinë, papastërtitë, ekspozimin ndaj mikrobeve dhe tensionet sipas standardeve më të fundit të IEC

Të pajisur me markën e konformitetit CE

(v) Mbrojtje ndaj ishullit (anti-islanding)

Invertori duhet të jetë i pajisur me ekran për të monitoruar të dhënat e paraqitura si më poshtë:

(i) Fuqia DC në hyrje

(ii) Tensioni DC në hyrje

(iii) Rryma DC

(iv) Fuqia AC në dalje

(v) Tensioni AC në dalje

(vi) Rryma AC në dalje

Kutitë Shpërndarëse

Të gjitha kutitë duhet të jenë të pajisura me elementet adekuate mbrojtëse, funksionalitetin e duhur dhe sigurinë (përfshirë siguresat, tokëzimin, etj).

Kutitë duhet të jenë të papërshkrueshme nga uji, parazitët, pluhuri, dhe duhet të jenë të prodhuar nga materiale termoplastike / metalike në përputhje me IEC 62208, rezistent ndaj rrezeve UV (ultraviolete) dhe ndaj zjarrit, si dhe të ketë mbrojtje minimale me IP 65 (ambient të jashtëm) dhe IP 20 (ambient të brendshëm).

Të pajisur me markën e konformitetit CE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy



Funded by
the European Union

Deklaroj se projekti: **Instalimi i sistemit fotovoltaik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike** është në përputhje me kërkesat e Rregullores së ZRRE për vetë –konsumatorët me Burime të Ripërtëritshme dhe se sistemi fotovoltaik i përmbushë të gjitha Standardet Teknike sipas thirrjes Nr. 02/2024 të datës 06.02.2024.

*Emri dhe mbiemri, Nënshkrimi i personit
përgjegjës të autorizuar nga kompania instaluese
dhe vula*

Plotësimi i këtij formulari nënkupton autorizimin e institucionit që të përdorë të dhënat e përfshira në të për qëllime të këtij projekti!

Vërejtje: Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Neni 299 - Mashtrimi i blerësve “1. Kushdo që me qëllim të mashtrimit të blerësve vë në qarkullim prodhime me shenjë në të cilën janë shënuar të dhëna të cilat nuk i përgjigjen përmbajtjes, llojit, prejardhjes apo kualitetit të produktit, vë në qarkullim produkte të cilat për nga pesha apo kualiteti nuk i përgjigjen asaj që rregullisht parashihet te produktet e tilla apo vë në qarkullim produkte pa shenjat që tregojnë për përmbajtjen, llojin, prejardhjen apo kualitetin e produktit kur shenja e tillë kërkohet me ligj, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”.

Emri dhe mbiemri i aplikuesit: _____

Nënshkrimi: _____

Data: _____ **Vendi:** _____